

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Shqipëria po përjeton të ardhmen që të tjerët ende po e diskutojnë"/ Rama nga OKB: Algoritmi aktivizoi urrejtjen, qytetarët protestuan kundër një armiku imagjinar izraelit
ADRESA	https://dosja.al/live-updates/shqiperia-po-per-jeton-te-ardhmen-qe-te-tjeret-ende-po-e-di-skutojne--i516058
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 18:46:41 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 18:27:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0b1e7a53a94e70081dc42121282213ce31be08c2d760a499ee1ca5ff0873fe05
TEKSTI	4ce737f84fd3327e4a1e3bc4da7193976b231174f8d37c9b320a2ec02df1a5f0
PAMJA	2e66655e9c1a9386c180262bb855811a3d423a5e6cac7d34a92e4683dd0fe132

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	497bb7b99b8c6b34186a733e6d3bcd4b875eeafe8c246946d8d25e6afea39df7
E MËPARSHMJA	21cc68be75a445962d848bf1f407062f5259f5c40099a94a00f1f5956fa00b92
RRËNJA MERKLE	6df622084e2aa16fa426f4c8614ee06bfd4531cb8fc83f4931cef87e966f1ea1
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/497bb7b99b8c6b34186a733e6d3bcd4b875eeafe8c246946d8d25e6afea39df7

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

1 ORE ME PARE

"Shqipëria po përjeton të ardhmen që të tjerët ende po e diskutojnë"/ Rama nga OKB: Algoritmi aktivizoi urrejtjen, qytetarët protestuan kundër një armiku imagjinar izraelit

3 ORE ME PARE

Dita e 118-të e protestës/ Qytetarët zbrasin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

5 ORE ME PARE

"Shqipëria e shqiptarëve është slogan i neveritshëm dhe i turpshëm"/ Rama: SHBA tradhtoi Hashim Thaçin, George Washingtonin e Kosovës

7 ORE ME PARE

Konflikt në Durrës/ Shefi i Policisë së Krujës përplaslet fizikisht me pronarin e ish-hotelit "Mira Mare": Nuk e kam kërcënuar, më shau, e shava

LIVE UPDATES

"Shqipëria po përjeton të ardhmen që të tjerët ende po e diskutojnë"/ Rama nga OKB: Algoritmi aktivizoi urrejtjen, qytetarët protestuan kundër një armiku imagjinar izraelit

• Kryeministri i vendit, Edi Rama mori pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, në SHBA. • Gjatë fjalës së tij ai foli për inteligjencën artificiale, protestën në Tiranë, algoritmin dhe raportin mes gënjeshtres dhe të vërtetës që qarkullon në platformat sociale. • Fillimisht Rama foli për zhvillimet e fundit në Shqipëri dhe ndikimin e inteligjencës artificiale. • Ai u shpreh se gjatë qëndrimit në OKB është surprizuar pozitivisht nga interesi i shumë bashkëbiseduesve për atë që po ndodh në Shqipëri, veçanërisht sa i përket përdorimit të inteligjencës artificiale. • Në lidhje me këtë, lideri i qeverisë tha se Shqipëria nuk është zhvilluese e modeleve të fjalës së fundit, por është një komb që e ka jetuar të ardhmen që të tjerët janë duke debatuar. • Ai theksoi se Shqipëria është i pari vend në botë që ka një ministere virtuale. • Më tej, kryeministri foli edhe për ndikimin që inteligjenca artificiale mund të ketë në marrëdhënien mes informacionit, së vërtetës dhe perceptimit njerëzor. • Sipas tij, çdo vendim me ndikim publik duhet të shoqërohet me një bazë dhe përgjegjësi të qartë ligjore. • Duke u ndalur tek protestat, Rama tha se një narrative e rreme për pushtimin e bregdetit shqiptar nga Izraeli u përdor për të nxitur reagime te qytetarët. • Sipas tij, qytetarët kishin arsye për të protestuar, por sipas tij ata u përballën me pretendime që nuk kishin ndodhur në realitet. • Ai tha se algoritmi aktivizoi urrejtjen, ndërsa zemërimi u bë mobilizim. Rama ngriti shqetësimin se liria e shprehjes po kërcënohet nga përdorimi si armë i fuqisë së shpërndarjes. • Gjatë fjalës së tij në Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Rama tha se kur një gënjeshtër shumëfishohet, e vërteta varroset. • Sipas tij, të mbrosh demokracinë dhe lirinë e secilit komb për të jetuar, nuk do të thotë të kontrollosh njerëzit çfarë mendojnë. • Në fund, kryeministri deklaroi se Shqipëria është kundër kufizimit të IA, por theksoi se nevojiten sisteme kundër manipulimeve. • Sipas tij, nevojitet një inteligjencë artificiale e verifikueshme, transparente dhe llogaridhënëse. Në lidhje me këtë, ai bëri të ditur se Shqipëria po ndërton një pasqyrë digjitale të mbështetur mbi inteligjencën artificiale.

6 artikuj për këtë temë.

2 ORE ME PARE

"Shqipëria ka zgjedhur novacionin"/ Rama: Pa një botë të përbashkët nuk mund të ketë Kombet e Bashkuara



editoriale

Eriseld Zeneli

Shqipëria, socializmi i Edi Ramës pa të majtën

Irena Beqiraj

Kostot e jetesës edhe lajmi se ekonomia po ecën mirë


Në vëmendje



Edi Rama

SHBA- Kryeministri Edi Rama ka theksuar rëndësinë e së vërtetës dhe të angazhimit të përbashkët në shoqëri. Gjatë fjalës së tij në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, lideri i qeverisë tha se pa një qëndrim të përbashkët ndaj së vërtetës nuk mund të ndërtohet një jetë publike e përbashkët dhe as një botë e përbashkët.

Në lidhje me këtë, ai tha se pa një botë të përbashkët nuk mund të ketë Kombet e Bashkuara. Ky ishte fjalimi i tij përmbyllës në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.



Edi Rama: Ne zgjedhim të vërtetën, sepse pa një angazhim të përbashkët nuk mund të kemi një jetë të përbashkët publike. Pa një botë të përbashkët nuk mund të ketë Kombet e Bashkuara. Këtu përfundon predikimi im në shkretëtirë dhe shpresa që kam, që është në fakt vendi i fundit ku mbështetem./Dosja.al

2 ORE ME PARE

Asambleja e OKB/ Rama: Jemi kundër kufizimit të IA, nevojiten sisteme kundër manipulimeve



Edi Rama

SHBA- Kryeministri Edi Rama ka deklaruar se është kundër kufizimit të IA, por theksoi se nevojiten sisteme kundër manipulimeve. Gjatë fjalës së tij në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Rama kjo nuk mund të jetë vetëm privilegj i vendeve të pasura pasi gënjeshtra udhëton kudo.

Sipas tij, nevojitet një inteligjencë artificiale e verifikueshme, transparente dhe llogaridhënëse. Në lidhje me këtë, ai bëri të ditur se Shqipëria po ndërton një pasqyrë digjitale të mbështetur mbi inteligjencën artificiale.

Në fund, ai tha se Shqipëria kërkon një marrëveshje ndërkombëtare për një inteligjencë artificiale, pasi gënjeshtrat udhëtojnë pa viza dhe algoritmet po i kapërcejnë kufijtë pa pasur nevojë për pasaportë.

INSIGHTS 25 SHTATOR 2026, 20:57

Kur të bie Diella në kokë

AKTUALITET 25 SHTATOR 2026, 12:08

"Të q*fsha motrën"/ Shefi i Policisë së Krujës shan qytetarin, ai zbret nga makina dhe e qëllon me shpullë (VIDEO)

POLITIKE 25 SHTATOR 2026, 10:13

BIRN: Zyrtarët e lartë dhe krimi i organizuar u bënë njësh në mbrojtje të Ergys Agasit

më të klikuarat

"Të q*fsha motrën"/ Shefi i Policisë së Krujës shan qytetarin, ai zbret nga makina dhe e qëllon me shpullë (VIDEO)

VIDEO/ Pamje të rënda nga atentati në Sarandë! Artan Myrtaj vrapon për t'u shpëtuar plumbave, autorët e ndjekin dhe qëllojnë në mes të rrugës



"O Kriminel, o mafia"/ Shqiptarët qëllojnë me vezë Edi Ramën në SHBA: E gjithë Shqipëria ty të urren

"Europa nuk ka arritur ta zbatojë"/ Rama nga SHBA: Paqja kusht politik që zhvillimi ekonomik e bën të mundur

insights

Besmir Semanaj

Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gagani

Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Arman Janaku

Kur PARTITË
harrojnë pse
ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1
euroshit ku Rama
zgjedh kush bëhet
biznesmen

Moti

Powered by  tomorrow

Edi Rama: Ne jemi kundër. Ne nuk mund të rregullojmë veten tonë deri në pafuqi. Për këtë pyetje, presidenti i SHBA-ve ka të drejtë, duhet të përshpejtojmë. IA në shërbim të qytetarëve, të përgjegjshme. Përgjigjja është kapacitet demokratik. Një inteligjencë sovran artificiale do të thotë që asnjë vend të mos jetë i pafuqishëm para vendeve që s'mund t'i kuptojë. Çdo vend duhet të jetë i aftë të mbrojë gjuhën e vet, të zbulojë koordinimet e manipuluar dhe të informojë qytetarët pa u varur nga një korporatë e largët. Ja pse Shqipëria po ndërton një pasqyrë dixhitale mbështetur mbi IA. Pasqyra do të zbulojë strukturat e koordinuara, jo vetëm ato që shihen.

Nuk do t'u thotë qytetarëve çfarë duhet të mendojnë. E drejta duhet të mbrohet haptazi. Pasqyra jonë ka për synim të shndërrohet në një infrastrukturë transparence, të mbrojë shoqërinë nga një industri gënjeshttrash. Qytetarët duhet të dinë kur përmbajtja politike me ndikim është gjeneruar artificialisht apo manipuluar. Arkitektura e shpërndarjes duhet të bëhet transparente, kush e krijoi apo shënjestroi. Sovraniteti dixhital s'mund të jetë privilegj i rezervuar për shtetet më të pasura. Gënjeshttrat udhëtojnë pa viza. Algoritmet i kapërcejnë kufijtë pa pasur nevojë për pasaportë./Dosja.al

2 ORE ME PARE


"Kur një gënjeshtër shumëfishohet, e vërteta varroset"/ Rama në OKB: Liria e shprehjes po kërcënohet nga përdorimi si armë i 'fuqisë së shpërndarjes'



Edi Rama

SHBA- Kryeministri Edi Rama tha se liria e shprehjes po kërcënohet nga përdorimi si armë i fuqisë së shpërndarjes. Gjatë fjalës së tij në Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Rama tha se kur një gënjeshtër shumëfishohet, e vërteta varroset.

Sipas tij, të mbrorsh demokracinë dhe lirinë e secilit komb për të jetuar, nuk do të thotë të kontrollosh njerëzit çfarë mendojnë. Rama tha se liria e shprehjes duhet mbrojtur duke garantuar transparencë mbi shpërndarjen e informacionit.





Edi Rama: Dy fqinj mund të jetojnë në të njëjtën rrugë, të votojnë në të njëjtat palë zgjedhje dhe të votojnë brenda realiteteve kryekëput të ndryshme. Kur kjo ndodh, demokracia nuk humbet thjeshtë një debat, por terrenin e përbashkët në të cilin bëhet i mundur debati. Sovraniteti nuk grryhet më në kufij. Sot në Europë ne po vrapojmë si të marrë për të hedhur gjithmonë e më shumë para që nuk i kemi për të mbrojtur tokat dhe qiejt tanë nga një luftë e mundshme në të ardhmen.

Por në shekullin që po jetojmë, kjo duhet të nënkuptojë krijimin e një shoqërie të lirë për të mbrojtur kushtet në të cilat qytetarët e tyre formojnë opinionin e vet. Pa këtë, sovraniteti mbi tokën dhe qiejt bëhet një iluzion. Sot liria e shprehjes kërcënohet nga përdorja si armë nga fuqia e shpërndarjes. Shpërndarja mund të manipulohet dhe të përdoret në mënyrë kriminale. Kur një gënjeshtër shumëfishohet miliarda herë, e vërteta varroset.

Qytetari mbetet i lirë të flasë, por në një stuhi që askush nuk mund ta dëgjojë. Përgjigja për të folurin e keq mbetet liri fjale, por për amplifikimin e fshehtë duhet të jetë ekspozim. Dhe duhet të bëhet sa më herët. Të mbrosh demokracinë dhe lirinë e secilit komb për të jetuar, s'do të thotë të kontrollosh njerëzit çfarë mendojnë. Nëse ne mbrojmë lirinë e shprehjes, duke e lënë kontrollin e shpërndarjes në terr, është njësoj si të mbrosh derën, por të dorëzosh gjithë dhomën./Dosja.al

2 ORE ME PARE

Protestat në Tiranë/ Rama justifikon revoltën: Algoritmi aktivizoi urrejtjen! Qytetarët protestuan kundër një armiku imagjinar izraelit




Edi Rama

SHBA- Kryeministri Edi Rama foli për protestat në Tiranë, të cilat po vijnë prej më shumë se tre muajsh, përmes të cilave është kërkuar dorëheqja e tij nga qeveria. Megjithatë, ai sërish nuk u mor me thelbin dhe problematikat për të cilat qytetarët protestojnë, por u justifikua duke ia vënë fajin algoritmit.

Gjatë fjalës së tij në Asambleen e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Rama tha se një narrativë e rreme për pushtimin e bregdetit shqiptar nga Izraeli u përdor për të nxitur reagime te qytetarët.

Sipas tij, qytetarët kishin arsye për të protestuar, por rrugës u përballën me pretendime që nuk kishin ndodhur në realitet. Ai tha se algoritmi aktivizoi urrejtjen, ndërsa zemërimi u bë mobilizim.





Edi Rama: Jam i bindur se ju e keni ndjekur revolucionin e flamingove, një narrativë e fabrikuar për pushtimin izraelit të bregdetit shqiptar, një pushtim që s'ka ndodhur kurrë, por kjo u fabrikua dhe u përcoll përmes zërave, faqeve dhe kanaleve. Qytetarët i kanë besuar tashmë. Qytetari mori një histori të tradhtisë kombëtare, një tjetër të provokimit fetar, një tjetër për një pushtim të jashtëm. Fabrikime të ndryshme u futën në botë të ndryshme emocionale dhe të gjitha i shërbenin gënjeshtërs strategjike. Pasojat ishin reale. Qytetarët kishin arsyet për të protestuar, por ata papritur ishin duke protestuar kundër një fantazme tashmë. Frika u bë zemërim, zemërimi u bë mobilizim dhe fabrikimi u bë realitet.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.